REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. P.SH. 2023/573; 2023/582
Datë/Datum. 14.11.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMI
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 2023/0573
2023/0582

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues i Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, nenit 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042), i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, si dhe nenin 50 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Ligji nr. 05/L-031, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit te ujësjellësit ne Komunen e Fushe Kosoves ne lagjen 28.29, Bardh i Madhe dhe Sllatine e Madhe " me nr. të prokurimit: "212-23-2115-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal MAPL, më 14/11/2023, mori këtë:

K O N K L U Z I O N

Ndryshohet/ plotësohet Vendimi me nr. të protokollit 2023/0573 dhe 2023/582, i datës 14.11.2023, që në faqen e parë te këtij vendimi konktretisht tek pika 1 dhe 3,e dispozitivit:

1. Refuzohen, si të pa bazuara ankesat e operatoreve ekonomik: "Alfa.I" e datës 11. 08. 2023 me Nr. 573/23 si dhe ankesa e OE "K-Ing" SH. P.K e datës 14. 08. 2023, Nr. 582/23, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit te ujësjellësit ne Komunën e Fushe Kosovës ne lagjen 28.29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe" me nr. të prokurimit: "212-23-2115-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal MAPL.

3. Meqenëse ankesa e GOE ankues është refuzuar si e pabazuar, të njëjtit i konfiskohet tarifa që ka paguar me rastin e parashtrimit të ankesës konform nenit 31 paragrafi 5 i Rregullores së Punës së OSHP-së dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e RKS-së.

Ndryshohet/plotësohet me fjalinë si më poshtë:

1. Aprovohen, si pjesërisht të bazuara ankesat e operatoreve ekonomik: "Alfa.I" e datës 11. 08. 2023 me Nr. 573/23 si dhe ankesa e OE "K-Ing" SH. P.K e datës 14. 08. 2023, Nr. 582/23, për aktivitetin e prokurimit me titull: "Rregullimi i rrjetit te ujësjellësit ne Komunën e Fushe Kosovës ne lagjen 28.29, Bardh i Madh dhe Sllatinë e Madhe" me nr. të prokurimit: "212-23-2115-5-1-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)-Ministria e Administrimit te Pushtetit Lokal MAPL.

2. Të mbetet ne fuqi vendimi I Autoritetit Kontraktues.

3. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Me rastin e përpilimit të Vendimit PSH. nr. 2023/0573 dhe 2023/582, i datës 14.11.2023, në faqen e parë është është lëshuar një gabim teknik dhe me këtë rast edhe bëhen plotësimet e duhura sipas këtij Konkluzioni.

Sipas kësaj rezultati përfundimtar nuk ka ndryshuar, vendimi i AK për dhënie të kontratës mbetet në fuqi.

Kryetari i panelit shqyrtues pasi që është njoftuar se ne vendimin e lartcekur ka lëshime teknike, në pajtim me nenin 50 të Ligjit për Procedurë Administrative Ligji Nr. 05/L -031, me anë të këtij konkluzioni bën korrigjimin e lëshimit duke vendosur si në dispozitiv te këtij konkluzioni.

Kryetari i panelit shqyrtues konform nenit 50 të Ligji Nr. 05/L -031, si dhe duke u bazuar në sqarimet e dhëna si më lart vendosi si në dispozitiv të këtij konkluzioni.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës komerciale- në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryesues i Panelit Shqyrtues

Vedat POTERQOI

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK – MAPL
1x1 OE ankues
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.